



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “ALEANCA
KONSERVATORE PËR SHQIPËRINË” PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT
ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Aleanca Konservatore Për Shqipërinë”, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vendimin e shkurtuar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, i shpallur në datën 21.02.2025 dhe nuk ka marrë formë të prerë;
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);

- b) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Aleanca Konservatore Për Shqipërinë” me shkronja nistore “AKPSH”, me adresë Rruga “Bardhok Biba”, Pll. 75, Shk. 2, Ap. 5, Kt. 1, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Altin Goxhaj, me adresë Rruga “Bardhok Biba”, Pll. 75, Shk. 2, Ap. 38, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Arbër Disha, me adresë Rruga “Shefqet Kuka”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Armando Vrushi, me adresë Rruga “Sulë Bega”, Pll. Ndregjoni, Ap. 21, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Aleanca Konservatore Për Shqipërinë”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se dokumentacioni i paraqitur nga Partia “Aleanca Konservatore Për Shqipërinë” nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nenin 64 pika 2, gërma “a” e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se së bashku me dokumentet e kandidimit për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ “Vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor, Tiranë”. Referuar dispozitave të sipërcituara, Partia “Aleanca Konservatore Për Shqipërinë” nuk e ka depozituar “Vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor, Tiranë”.

Licela VELIU -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Pavlina DOÇAJ -Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA -Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)